



BASHKIA
TIRANË

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA TIRANË

DREJTORIA E PËRGJITHSHME E RRUGËVE DHE NDRIÇIMIT PUBLIK

FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT

Datë 25.01.2021

Nga: Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve dhe Ndrëçimit Publik.

Drejtuar: Bashkimit të Operatorëve Ekonomik “**KEGLI-DURI**” sh.p.k, me NUIS K94016202U, me adresë: Lagjja Grumbullimit, rruga e Laçit, pallat i ri, kati 1, Fushë Krujë, Durrës dhe “**EURO-ALB**” sh.p.k, me NUIS K66613407H, me adresë: Lagjja Minatori, Rruga e Spitalit, Pallati nr.12, Shk.1, Kati 5, Ap.15, Bulqizë, Dibër.

Procedura e prokurimit: E hapur.

Numri i referencës së procedurës: REF-79347-11-20-2020.

Përshkrim i shkurtër i kontratës: “Rikonstuksion i Shkarkuesit Katastrofik të Ujësjetës, Rezervuari Allgjatë”, me fond limit 12.062.500 (dymbëdhjetë milion e gjashtëdhjetë e dy mijë e pesëqind) lekë pa tvsh, **afati:** Brenda 3 (tre) muajve nga data e fillimit të punimeve.

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: çmimi më i ulët **X**, oferta ekonomikisht më e favorshme

Publikime të mëparshme (*nëse zbatohet*): Buletini i Njoftimeve Publike Nr. 111, Date 01.12.2020.

Njoftojmë se, kanë qenë pjesëmarrës në procedurë këta ofertues me vlerat përkatëse të ofruara si më poshtë:

1. Operatori ekonomik “**2N**” sh.p.k, me NUIS L31615017L dhe me ofertë 7.288.908 (shtatë milion e dyqind e tetëdhjetë e tetë mijë e nëntëqind e tetë) lekë pa tvsh.
2. Bashkimi i Operatorëve Ekonomik “**KEGLI-DURI**” sh.p.k, me NUIS K94016202U dhe “**EURO-ALB**” sh.p.k, me NUIS K66613407H, me ofertë 8.235.543 (tetë milion e dyqind e tridhjetë e pesë mijë e pesëqind e dyzet e tre) lekë pa tvsh.
3. Operatori ekonomik “**SIRETA 2F**” sh.p.k, me NUIS K51501008J dhe me ofertë 9.999.999 (nëntë milion e nëntëqind e nëntëdhjetë e nëntë mijë e nëntëqind e nëntëdhjetë e nëntë) lekë pa tvsh.
4. Operatori ekonomik “**STERKAJ**” sh.p.k me NUIS J68310708M dhe me ofertë 10.458.624,23 (dhjetë milion e katërqind e pesëdhjetë e tetë mijë e gjashtëqind e njëzet e katër presje njëzet e tre) lekë pa tvsh.

5. Operatori ekonomik “**V.A.S KONSTRUKSION**” sh.p.k me NUIS L61322023P dhe me ofertë 11.071.274 (njëmbëdhjetë milion e shtatëdhjetë e një mijë e dyqind e shtatëdhjetë e katër) lekë pa tvsh.

Janë skualifikuar ofertuesit e mëposhtëm:

1. “**2N**” sh.p.k me NUIS L31615017L

Përkatësisht për arsyet e mëposhtme:

1.Nuk përmbush pikën 2.3.1 të kapacitetit teknik ku është parashikuar se: *”Përsa i përket aftësisë teknike e profesionale, Operatori Ekonomik duhet të përmbushë kërkesat e mëposhtme minimale të cilat vendosen nga Autoriteti Kontraktor si më poshtë:*

Përvojë e suksesshme në realizimin e të paktën:

- a) *Punë të ngjashme për një objekt të vetëm me vlerë jo më të vogël se 50% e vlerës së përllogaritur të kontratës që prokurohet dhe konkretisht: **6.031.250 (gjashtë milion e tridhjetë e një mijë e dyqind e pesëdhjetë) lekë pa tvsh, të realizuar gjatë tri viteve të fundit nga data e zhvillimit të procedurës.***
- b) *Punë të ngjashme deri ne nje kufi ku vlera monetare totale e punëve të kryera e marrë së bashku është në një vlerë jo më të vogël se dyfishi i fondit limit të procedurës që prokurohet dhe konkretisht: **24.125.000 (njëzet e katër milion e njëqind e njëzet e pesë mijë) lekë pa TVSH, të realizuar gjatë tri viteve të fundit nga data e zhvillimit të procedurës.***

Plotesimi i njerit prej dy kushteve te siperpermendura e ben oferten te kualifikueshme.

Pika 1/a plotësohet nga anëtari i cili ka përqindjen më të madhe të pjesëmarrjes në bashkim. Anëtarët e tjerë të bashkimit do të paraqesin kontratat e ngjashme në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim. Kurse pika 1/b duhet të plotësohet nga të gjithë anëtarët e bashkimit në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.

Vlerësimi i përvojës së suksesshme të Operatorit Ekonomik do të kryhet bazuar në deklaratat e dokumentat e mëposhtme:

- a) *Për kontrata të realizuara me ente publike, Operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm:*
- *Formular vlerësimi per realizimin e punimeve sipas shtojcës Nr. 9;*
 - *Kontratë Sipërmarrje;*
 - *Situacionin përfundimtar;*
 - *Aktin e kolaudimit;*
 - *Çertifikaten e marrjes ne dorezim/Çertifikatën e Përkohshme të marrjes ne dorezim.*
- b) *Për kontrata të realizuara me sektorin privat, Operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm:*

- *Kontrate Sipërmarrje;*
- *Situacionin përfundimtar;*
- *Akt kolaudimi objekti;*
- *Çertifikaten e marrjes ne dorezim/ Çertifikatën e Përkohshme të marrjes ne dorezim;*
- *Fatura tatimore per cdo situacion punimesh.*

- *Per kontratat e realizuara si Bashkim Operatorësh, Operatori ekonomik ofertues duhet te paraqesë: Kontratën e Bashkimit të Operatorëve si dhe Prokurën e Posaçme te deklaruar ne fazen e tenderimit.*
- *Per kontratat e realizuara si Nënkontraktor, Operatori ekonomik ofertues duhet te paraqesë: Kontratën e Nënkontraktimit; Kontratën bazë ndërmjet Kontraktorit dhe Autoritetit Kontraktor si dhe Miratimi zyrtar si nenkontraktor i deklaruar nga ana e autoritetit kontraktor.”*

Nga verifikimi që Komisioni i Vlerësimit të Ofertave i ka bërë dokumentacionit të ngarkuar në Sistemin e Prokurimit Elektronik nga operatori ekonomik “2N” sh.p.k rezulton se ai ka paraqitur për përmbushjen e kriterit të punëve të ngjashme vetëm një kontratë si mëposhtë vijon:

- Kontratë për realizimin e punimeve me Nr. 16/13 Prot., datë 05.07.2019, lidhur ndërmjet Bashkisë Dibër dhe Bashkimit të Operatorëve Ekonomik “2N” sh.p.k dhe “K.M.K” sh.p.k me objekt “Rikonstruksioni dhe mirëmbajtje e Kanaleve Ujitëse Bashkia Dibër 2019”, me vlerë 6.282.406 pa tvsh dhe 7.538.888 me tvsh.
- Kontratë për bashkëpunim të përkohshëm ndërmjet shoqërisë “2N” sh.p.k dhe shoqërisë “K.M.K” sh.p.k, ku palët marrin përsipër zbatimin e kontratës sipas objektit të sipërpërmendur sipas këtyre përqindjeve:

“2N” sh.p.k	58%
“K.M.K” sh.p.k	42%

- Prokurë e posaçme lëshuar nga shoqëria “K.M.K” sh.p.k për shoqërisë “2N” sh.p.k, si kryesuese e Bashkimit të Operatorëve Ekonomik.
- Faturë tatimore shitje dhe situacioni nr.1
- Faturë tatimore shitje dhe situacioni përfundimtar
- Akti kolaudimi
- Akt marrje në dorëzim
- Procesverbal për marrjen përfundimtare në dorëzim të objektit
- Formular vlerësimi

Nga shqyrtimi që Komisioni i ka bërë dokumentacionit të listuar më lart rezulton se operatori ekonomik “2N” sh.p.k, si anëtar i bashkimit të operatorëve ka kryer 58% të punimeve të kësaj kontrate, përkatësisht në vlerën 3.643.795 lekë pa tvsh.

Ndodhur para këtyre kushteve, operatori nuk përmbush kriterin e punëve të ngjashme pasi vlera e paraqitur prej 3.643.795 lekë pa tvsh është më e vogël se vlera prej 6.031.250 (gjashtë milion e tridhjetë e një mijë e dyqind e pesëdhjetë) lekë pa tvsh, e kërkuar në

pikën 2.3.1 të kapacitetit teknik të DST në rastin e paraqitjes së punëve të ngjashme për një objekt të vetëm.

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë Bashkimin e Operatorëve Ekonomik **“KEGLI-DURI”** sh.p.k, me NUIS K94016202U, me adresë: Lagjja Grumbullimit, rruga e Laçit, pallat i ri, kati 1, Fushë Krujë, Durrës dhe **“EURO-ALB”** sh.p.k, me NUIS K66613407H, me adresë: Lagjja Minatori, Rruga e Spitalit, Pallati nr.12, Shk.1, Kati 5, Ap.15, Bulqizë, Dibër se oferta e paraqitur, me një vlerë të përgjithshme prej 8.235.543 (tetë milion e dyqind e tridhjetë e pesë mijë e pesëqind e dyzet e tre) lekë pa tvsh, është identifikuar si oferta e suksesshme.

Rrjedhimisht, jeni të lutur të paraqisni pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Rrugëve dhe Ndriçimit Publik, Rruga “5 Maji”, sigurimin e kontratës siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda 5 (pesë) ditëve që nga dita e marrjes së këtij njoftimi.

Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, do të veprohet siç parashikohet në nenin 58 të Ligjit nr. 9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

Njoftimi i klasifikimit është bërë në datë 15.01.2021.

Ankesa: Nuk ka